

SBASHK Arsimimi sot

Prill, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK –u mbajti protestë më 1 maj Me sjellje e qëndrim pjesëmarrësit lartësuan figurën e mësuesit



Për ta ngritur fuqishëm zërin drejtuar Qeverisë për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë SBASHK-u mbajti protestë më 1 maj me pjesëmarrjen e kryetarëve dhe udhëheqësve sindikal të çerdheve, shkollave dhe universiteteve. Kryetarët dhe udhëheqësit sindikal ishin nisur me kohë nga e tërë Kosova për t'u bërë bashkë në oborrin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ata përshëndeteshin me njëri-tjetrin e me stafin qendror dhe bashkëbisedonin për rrjedhën e mbarë të këtij veprimi sindikal... (faqe 3)

Trajnime të organizuara në shërbim të anëtarësisë në Rahovec e Drenas
Pjesëmarrësit shprehin respekt meritore për angazhimet e SBASHK-ut



Duke respektuar vullnetin e kolegeve e kolegëve tanë në Rahovec shprehur përmes kryetarit të Kuvendit të Sindikatës të Arsimit Parauniversitar për... (faqe 4-5)

Sindikatat e Arsimit të rajonit bashkëbiseduan në Mal të Zi



Në Konferencën Regjionale “Kontrata kolektive në sektorin e arsimit – përvojat krahasuese“... (faqe 4)

Kuvend zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prishtinës Kryetare u zgjodh Drita Dushi Parduzi



Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prishtinës... (faqe 6)

Një vizitë e veçantë në SBASHK

Studentët e gazetarisë prezantuan vizionin e projektit për mediet në vitin 2024



Studentët e Departamentit të Gazetarisë kanë vizituar selinë e SBASHK-ut... (faqe 5)

Editorial

Dëshmi e unitetit dhe besimit të plotë në SBASHK-un



E vonuam pak përgatitjen dhe publikimin gazetës sonë për muajin prill me dëshirë që ju lexues të nderuar ta keni edhe shkrimin për protestën e 1 majit në të cilën morën pjesë kryetarët dhe udhëheqësit sindikal që nga çerdhet, shkollat dhe universitetet. Numri i pjesëmarrësve dhe qëndrimi plot dinjitet i tyre që nga tubimi në oborrin e Bibliotekës Kombëtare, pastaj marshimi nëpër rrugët e sheshet e kryeqytetit dhe sjelljet gjatë protestës deri në përfundimin e saj dëshmuar për kulturën e lartë njerëzore të mësuesit dhe për unitetin dhe besimin e tyre të plotë në SBASHK-un.

SBASHK-u falënderon mediet

për korrektësinë dhe për praninë gjatë gjithë këtij veprimi sindikal .Po ashtu falënderojmë edhe policinë e Kosovës që me angazhim të përkushtuar ndihmojë që e tërë protesta të ketë rrjedhë të mbarë.

Gjatë gjithë marshimit u lexuan me dhjetëra herë kërkesat legjitime të anëtarësisë dhe urojmë që Qeveria ta ketë kuptuar mesazhin dhe qëllimin tonë e të fillojë me dialogun dhe me realizimin e kërkesave tona. SBASHK-u mbetet i përkushtuar për dialog dhe beson shumë se me vullnetin edhe të palës tjetër kërkesat lehtë mund të realizohen.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotete në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Gjatë muajit

SBASHK –u mbajti protestë më 1 maj

Me sjellje e qëndrim pjesëmarrësit lartësuan figurën e mësuesit



Për ta ngritur fuqishëm zërin drejtuar Qeverisë për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë SBASHK-u mbajti protestë më 1 maj me pjesëmarrjen e kryetarëve dhe udhëheqësve sindikal të çerdheve, shkollave dhe universiteteve. Kryetarët dhe udhëheqësit sindikal ishin nisur me kohë nga e tërë Kosova për t'u bërë bashkë në oborrin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ata përshëndeteshin me njëri-tjetrin e me stafin qendror dhe bashkëbisedonin për rrjedhën e mbarë të këtij veprimi sindikal. Kryetari Jasharaj takohej e fotografohej me shumë nga pjesëmarrësit dhe përgjigjej edhe në pyetjet e shumë medieve që kishin ardhur ta përcjellin protestën e SBASHK-ut. Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me anëtarët e stafit Afërditën, Blendin e Nezin komunikonin me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve dhe u shpërndanin flamuj të SBASHK-ut dhe kërkesat e anëtarësisë që ishin përgatitur me kujdes. Për ta dëshmuar unitetin dhe respektin për sindikatën e tyre pjesëmarrësit kishin përgatitur pankarta emrin e komunës nga vinin dhe opinionin e pa se kryetarë e udhëheqës të shoqatave sindikale nga e tërë Kosova ishin, si gjithmonë, edhe më 1 maj bashkë e të përkushtuar në shërbim të anëtarësisë.



Pjesëmarrësit filluan marshimin dhe kryetarët e sindikatës sonë për Klinën dhe Prizrenin Arif e Elezaj e Reshit Kushaj përmes altoparlantit i kanë thënë zëshëm kërkesat e anëtarësisë drejtuar MASHTI-it dhe Qeverisë.

SBASHK shpreh respekt meritore dhe falënderon policinë e Kosovës për angazhimin dhe kontributin për rrjedhën e mbarë të protestës që nga fillimi i marshimit e deri në përmbylljen e këtij veprimi sindikal, pjesë e të cilit e me një numër anëtarësh ishte edhe Federata e Punëtorëve ndihmës të sektorit privat që udhëhiqet nga Jusuf Azemi.

Marshimin, që nisi nga oborri i Bibliotekës Kombëtare e për të vazhduar drejt MASHTI, Konvikteve, Katedrales dhe sheshit të kryeqytetit e për t'u ndalur para Qeverisë e kanë përcjellë e përkushtim e korrektësi të gjitha mediet shkruara e elektronike dhe SBASHK i falënderon shumë për profesionalizmin e treguar. Me të arritur para Qeverisë konferencierja Nezafete Jakupi ka përshëndetur pjesëmarrësit e protestës e pastaj ka ftuar për fjalë rasti kryetarin Jasharaj, kryetarin e Azemi dhe kryetarin e BSPK-së Atdhe Hykolli.

Në këtë shkrim po kujtojmë edhe një herë kërkesat e anëtarësisë, kurse fotografitë ju sjellin pamje nga ky aktivitet sindikal i SBASHK-ut që mori vlerësim të lartë nga opinioni.

- Duam dialog social për realizimin e kërkesave tona
- Nuk lejojmë të bëhen ndryshime të ligjeve në dëm të punëtorëve të arsimit
- Kërkojmë nënshkrimin e aneks Kontratës Kolektive të Arsimit sidomos për ruajtjen e vendeve të punës
- Qeveri respekto pensionistët sepse ju arsimuan edhe juve
- Kërkojmë urgjentisht të ngritet vlera e koeficientit të pagave për se paku 30%
- Kërkojmë përmirësimin e kushteve të punës në institucionet arsimore
- Plotësimi i Ligjeve të mos bëhet pa pajtimin e sindikatave
- Duam Funkcionalizimin e Këshillit Ekonomik Social
- Kërkojmë që norma javore të jetë 18 orë si në shtetet e rajonit
- Qeveria të sigurojë buxhet për zbatimin e Kontratës Kolektive pa pasur nevojë të shkohet në gjykata
- Qeveri zbato vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pagesën e përvijës së punës 0.5% edhe për 15 vitet e para të punës
- Kërkojmë të kemi përfaqësues të punëtorëve në komisione e borde në të cilat vendoset për çështje jetike për punëtorët



Sindikatat e Arsimit të rajonit bashkëbiseduan në Mal të Zi

Konferenca Regjionale “Kontrata kolektive në sektorin e arsimit – përvojat krahasuese” Konferenca Regjionale “Sindikatat dhe përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve”

Me 23 Prill 2024 në Podgoricë, Sindikata e Arsimit e Malit të zi në bashkëpunim me Qendrën e Solidaritetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me seli në Tiranë dhe Qendrën e Solidaritetit me seli në Beograd mbajtën Konferencën Regjionale me temën “ Kontrata kolektive në sektorin e arsimit – përvojat krahasuese “.

Konferencën e hapi kryetari i sindikatës së arsimit të Malit të zi z.Radomir Bozhovic i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falenderoj të gjitha sindikatat e arsimit që kishin gjetur kohë të jenë në konferencë, tregojë edhe për gjendjen aktuale të sindikatës së arsimit të Malit të zi. Me një fjalë përshëndetëse ju drejtua të pranishmëve edhe Drejtori i programit të Qendrës së Solidaritetit me seli në Beograd z.Sasha Uzelac i cili tha se është në mbështetje të sindikatave.

Në Konferencën Regjionale “Kontrata kolektive në sektorin e arsimit – përvojat krahasuese” murrën pjesë përfaqësuesit nga Sindikatat e Arsimit të Sllovenisë, Sindikata e Arsimit të Kroacisë, Sindikata e Arsimit të Shqipërisë, Sindikata e Arsimit të Malit të zi, Sindikata e Arsimit të Sërbisë, Sindikata e Arsimit të Maqedonisë së veriut, Sindikata e Arsimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Sindikata e Arsimit të Republikës Serbe të Bosnjës dhe përfaqësues nga SBASHK-u ishin nënkryetarja z.Vjollca Shala dhe kordinatori për organizim të brendshëm z.Ymer Ymeri.

Në konferencë u debatua për pagat, pagën më të ulët, pagën mesatare, kur ka qenë hera e fundit që është rritur paga dhe në çfarë mase, dhe disa specifika dhe shtesa në pagën bazë. Pastaj, u debatuar për çmimet jubilarë, shtesa për festa, shtesa për pushime etj.,pagesa e shpenzimeve të transportit për punëtorët e arsimit, pushim me pagesë/mungesë me pagesë nga puna, pagesat e pagave përcjellëse pas largimit në pension, stimulimi për licenca dhe disa specifika që

lidhen me secilin vend veç e veç.

Deri sa vite më herët pagat e punëtorëve të sektorit të arsimit në Kosovë ishin afërsisht të barabarta apo edhe më të larta se pagat e punëtorëve të arsimit të shteteve të regjionit tani në konferencë u pa se pagat më të ulët në sektorin e arsimit ishin në Kosovës. Benifitet nga kontrata kolektive ishin më të larta në kontratat kolektive të regjionit të cilat punëtorët e tyre të arsimit i gëzonin pa shkuar fare në gjykata ndërsa, punëtorët tonë të arsimit benifitet që janë me kontratën kolektive të SBASHK-ut i gëzojnë vetëm përmes gjykatave.

Përfaqësuesit e SBASHK –ut nënkryetarja z.Vjollca Shala dhe kordinatori për organizim të brendshëm z.Ymer Ymer kanë dhënë kontribut të çmuar në këto dy konferenca të mbajtura në Malin e zi duke treguar për pagat e punëtorëve të arsimit , pagën më të ulët, pagën mesatare. Punëtorët në Kosovë nuk kanë pagesa shtesë për festa apo pushime. Shpërblimet jubilarë, pagesa e shpenzimeve të transportit, pagesat e pagave përcjellëse pas largimit në pension, stimulimi për licenca punëtorët e arsimit i fitojnë vetëm përmes gjykatave.

Me 25,26 dhe 27 Prill 2024 në Petrovacë, Mali i zi u mbajt edhe një konferencë regjionale për sindikatat dhe përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve. Në konferencë u debatua për përfaqësuesit e sindikatave, të drejtat e komuniteteve dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve në marrveshjet kolektive.



Trajnime të organizuara në shërbim të anëtarësisë në Rahovec e Drenas

Pjesëmarrësit shprehin respekt merit për angazhimet e SBASHK-ut



Duke respektuar vullnetin e kolegeve e kolegëve tanë në Rahovec shprehur përmes kryetarit të Kuvendit të Sindikatës të Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Veli Morina, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror kanë bërë gjithë përgatitjet dhe me sukses ka nisur trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, udhëhequr nga trajneri Albert Samadraxha. Për të bashkëbiseduar

me pjesëmarrësit kanë shkuar në Rahovec kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri të cilët fillimisht janë takuar me kryetarin Veli Morina, me drejtorin e shkollës “Isa Boletini”, Sakip Kryeziu, me veprimtarin sindikal Hajredin Kadiri dhe me kryetaren e shoqatës sindikale të shkollës, në të cilën zhvillohet trajnimi, Xhylsime Shala.

Duke ju dëshiruar mirëseardhje drejtori Kryeziu ka njoftuar mysafirët për angazhimet e shumta në shkollën, që ai drejton dhe është shprehur krenar me të punësuarit këtu, që bëjnë angazhime maksimale për arsimimin dhe edukimin e brezave. Përfaqësuesit e SBASHK-ut bashkë me mikpritësit janë gjendur pastaj në ambientet e shkollës “Isa Boletini” për të përshëndetur pjesëmarrësit e trajnimit e për të falënderuar trajnerin Samadrxha për përkushtimin e tij maksimal me qëllim që pjesëmarrësit të marrin sa më shumë njohuri të reja për modulet e kompjuterit.

Në fillim të fjalës së tij përshëndetëse kryetari Jasharaj ka përgëzuar kryetarin Veli Morina dhe veprimtarët sindikal nga kjo komunë për angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe për kontributin e rrjedhës së mbarë të aktiviteteve sindikale në Rahovec, por edhe në nivelin qendror. Jasharaj ka falënderuar drejtorin Kryeziu për mikpritjen dhe për angazhimin që ky trajnim të realizohet në një ambient të përgatitur me të gjitha kushtet e duhura. Pjesëmarrësit i kanë përshëndetur edhe kryetari i sindikatës sonë për këtë komunë Veli Morina dhe drejtori i shkollës Saip Kryeziu dhe pastaj është zhvilluar një bashkëbisedë me pjesëmarrësit e këtij trajnimi dhe pyetjeve të tyre u është

përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Një aktivitet në shërbim të anëtarësisë është zhvilluar edhe në Drenas. Duke respektuar vullnetin e mësimdhënësve të kësaj komune koordinatori për organizim të brendshëm



Ymer Ymeri bashkë me stafin e në koordinim me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Ilaz Dervishaj kishin bërë gjithë përgatitjet për fillimin e suksesshëm të trajnimit “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga formate rrezikshme të punës”, udhëhequr nga trajnerja Nora Ajeti. Ky aktivitet është zhvilluar në ambientet e gjimnazit “Gjergj Kastrioti –Skënderbeu”. Pjesëmarrësit e këtij trajnimi i ka vizituar kryetari Dervishaj, i cili ka përgëzuar trajneren Ajeti dhe stafin qendror të SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë.



Një vizitë e veçantë në SBASHK

Studentët e gazetarisë prezantuan vizionin e projektit për mediet në vitin 2024

Studentët e Departamentit të Gazetarisë kanë vizituar selinë e SBASHK-ut dhe pas një bashkëbisede e fjalës së mirëseardhjes nga kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, pjesëtarja e këtij projekti, Learta Beqiri, prezantoi para stafit dhe veprimtarëve të SBASHK-ut vizionin për mediet e se ardhmes. Ajo ka përmendur sfidat e gazetarisë duke u ndalur edhe të rëndësia e edukimit medial në shkolla.

Beqiri dhe studentet tjera të gazetarisë në bashkëbisedë me stafin e SBASHK-ut kanë bërë apel që të inkurajohen mësimdhënësit kudo në Kosovë që të angazhohen me përkushtim që edukimi medial të jetë lëndë zgjedhore në shkolla. Kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar studentët dhe profesorët e Departamentit të Gazetarisë për këtë iniciativë që ka të bëjë me vizionin e të ardhmes së medie.



Kuvend zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prishtinës Kryetare u zgjodh Drita Dushi Parduzi



Në ambientet e Qendrës Burimore “Përparimi” u mbajt Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prishtinës. Në hapje të këtij Kuvendi kryetari Ahmet Pllana ka falënderuar pjesëmarrësit për angazhimet e përbashkëta në shërbim të anëtarësisë, duke kujtuar edhe momente plot sfida, por edhe arritjet e shumta të SBASHK-ut. Kryetari Pllana në vazhdim të këtij takimi ka prezantuar Raportin e punës dhe atë financiar, raporte këto që janë aprovuar nga anëtarët e këtij Kuvendi. Pllana ka falënderuar kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymri duke i përgëzuar për gjithë angazhimet dhe përkushtimin në shërbim të anëtarësisë dhe për bashkëpunimin korrekt gjatë gjithë këtyre viteve.

Kryetari Jasharaj është shprehur se ndjehet krenar që u angazhua me vite të tëra me Ahmetin duke u përballur suksesshëm me sfidat e shumta të kohës. Edhe nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë falënderuar kolegun Ahmet Pllana për gjithë përkushtimin dhe angazhimet e përbashkëta gjatë gjithë këtyre viteve.

Në pjesën e dytë të këtij Kuvendi zgjedhor përmes votës së fshehtë kryetare u zgjodh Drita Dushi Parduzi, kurse nënkryetar Shpejtim Hyseni.

Kryetarja Parduzi është shprehur se ndjehet krenare me besimin e dhënë duke premtuar angazhim bashkë me kryesinë dhe veprimtarët sindikal në shërbim të anëtarësisë.



Flasin disa nga pjesëmarrësit e protestës së SBASHK-ut më 1 maj Krenohemi me qëndrimin plot dinjitet të pjesëmarrësve

SBASHK më 1 maj organizoi protestë me pjesëmarrjen e kryetarëve dhe udhëheqësve sindikal të shoqatave sindikale nga çerdhet, shkollat, njësitë akademike të universiteteve të Kosovës. Protesta tregoi unitetin e shkëlqyer në SBASHK dhe dërgoi mesazhe të qarta të Qeveria që të angazhohet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë për të parandaluar veprimet tjera sindikale.

Pjesëmarrësit shpreheshin krenar për rrjedhën e protestës dhe për pjesëmarrjen kaq të madhe të kryetarëve dhe udhëheqësve sindikal. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj është përshëndetur me shumë nga pjesëmarrësit duke i falënderuar për pjesëmarrjen dhe qëndrimin plot dinjitet. “Ndjehem krenar me ju pjesëmarrës të nderuar të protestës. Ju jeni përfaqësues të anëtarësisë sonë dhe sot

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

në emër të tyre e me këtë pjesëmarrje po ngritni fuqishëm zërin e anëtarësisë së SBASHK-ut dhe po arsyetoni besimin e tyre”, është shprehur Jasharaj.

Nënkryetarja Vjollca Shala duke parë gjithë atë numër të pjesëmarrësve është shprehur se këto kolege e kolegë , që janë kryetar e udhëheqës të shoqatave sindikale tregojnë përkushtimin dhe unitetin e shkëlqyer në SBASHK. Ne bashkë jemi zëri i anëtarësisë dhe kështu po dëshmojmë unitetin dhe besimin e ndërsjellë.

Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin po bashkëbisedonte me pjesëmarrësit dhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal po u shpërndanin flamujt e SBASHK-ut dhe po analizonin bashkë rrjedhën e marshimit dhe të vetë protestës. Ai është shprehur krenar

me kryetarët e udhëheqësit sindikalë që kishin ardhur në numër kaq të madh e në mënyrë kaq të organizuar për të ngritur zërin e për të kërkuar realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë.

Krenar me kryetarët dhe udhëheqësit sindikal të shoqatave sindikale nga komuna e tij ishte edhe Fejzullah Vranovci , kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Ferizajt.

Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve dhe anëtar i kryesisë së SBASHK-ut , Bardh Bardhi, po ashtu është shprehur krenar duke parë se edhe kryetar e udhëheqës sindikal nga njësitë akademike të universiteteve të Kosovës ishin pjesë e kësaj proteste.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture